



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

REPUBLICA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO	
VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO	
MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL	
MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, ŠUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA	
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT	
AGJENCIA PËR ZHVILLIMIN E BUJQËSISË - AGENCIJA ZA RAZVOJ POLJOPRIVREDE	
AGENCY FOR AGRICULTURAL DEVELOPMENT	
Prilloga Org. 0714	Nr. Prot. 517
Prilloga No. 2	Prot. No.
Nr. i kopjeve	Data 17.03.2016
No. pages: 2	Date
PRISHTINE/A	

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

*Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë / Agencija za Razvoj Poloprivrede /
Agriculture Development Agency*

THIRRJE PËR APLIKIM

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural fton të gjithë fermerët e interesuar që të aplikojnë për mbështetje përmes Programit për Pagesa Direkte 2016.

Përkrahja jepet për disa kultura dhe aktivitete bujqësore, si më poshtë:

- Pagesa direkte për mbjellje të grurit;
- Pagesa direkte për mbjellje të farës së grurit;
- Pagesa direkte për mbjellje të elbit;
- Pagesa direkte për mbjellje të thekrës;
- Pagesa direkte për mbjellje të misrit;
- Pagesa direkte për mbjellje të lule diellit;
- Pagesa direkte për vreshta ekzistuese;
- Pagesa direkte për pemishtet ekzistuese;
- Pagesa direkte për prodhimtarinë e materialit fidanor të pemëve drufrutore dhe hardhisë së rrushit mbi nënshartesat vegjetative;
- Pagesa direkte për perime në fushë të hapur;
- Pagesa direkte për lopë dhe buallica qumështore;
- Pagesa direkte për dele;
- Pagesa direkte për dhi;
- Pagesa direkte për bletari;
- Pagesa direkte për pulat vojse;
- Pagesa direkte për dosa në riprodhim (Derrari);
- Pagesa direkte për bujqësi organike;
- Pagesa direkte për thëllëza.

Periudha e aplikimit:

Aplikimi zgjatë 40 ditë kalendarike dhe fillon prej momentit të shpalljes publike, nga data 17 Mars deri me 25 Prill 2016.

Mënyra e aplikimit:

Aplikimi bëhet në zyrat e Drejtorive Komunale për Bujqësi.

Për të gjitha Pagesat Direkte për sipërfaqe duhet të bëhet digitalizimi i parcelave përmes programit sLPIS.

Për të gjitha Pagesat Direkte për blegtori duhet të dorëzohet regjistri i lëshuar nga Praktikat Veterinare të kontraktura nga AUV, duke u bazuar në të dhënat e sistemit të Identifikimit dhe Regjistrimit të kafshëve në AUV;

Në rast se një fermer aplikon për disa kultura apo aktivitete bujqësore, plotësohet dhe dorëzohet vetëm një aplikacion.

Gjatë procedurës së kontrollit në terren, në rast të gjetjes së shkeljeve, do të aplikohen masa ndëshkimore, duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ MBPZHR 04/2016.

Sqarim:

Dokumentacioni për aplikim duhet të dorëzohet në dy kopje dhe brenda periudhës së aplikimit. Dorëzimi i dokumentacionit pas përfundimit të afatit të publikuar dhe i pakompletuar, nuk do të pranohet për shqyrtim.

Informatat:

Për kriteret dhe procedurat për aplikim, informatat e hollësishme mund të merren në ueb faqen e MBPZHR-së, www.mbpzhr-ks.net dhe të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë, www.azhb-ks.net, si dhe në Drejtoritë Komunale për Bujqësi.